



Nr. 74 prot  
Dt. 12/12/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 9 Datë 11.12.2018

**“PËR MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ALBINMINE” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit “ALBINMINE” SH.P.K., me propozim të A.B.U. Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “ALBINMINE” SH.P.K me administrator Z. Dogan TOPOYAN, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Leshnices**, degë e lumit Drin i Zi, për prodhim energjie elektrike në fshatin Surroj, Njësia Administrative Surroj, Bashkia Kukës , Qarku Kukës .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC KAPITI do të ketë këto të dhëna në KRGJSH:

Koordinatat e veprës së marrjes nr.1:  $X_1 - 52\ 44\ 64$ ;  $Y_1 - 46\ 48\ 333$ ;  $Z_1 - +900\ m$ ;

Koordinatat e veprës së marrjes nr.2:  $X_2 - 52\ 46\ 33$ ;  $Y_2 - 46\ 50\ 356$ ;  $Z_2 - +960\ m$ ;

Koordinatat e godinës së centralit:  $X - 52\ 54\ 78$ ;  $Y - 46\ 49\ 846$ ;  $Z - +740\ m$ ;

Koordinatat e pikes së shkarkimit :  $X - 52\ 54\ 78$ ;  $Y - 46\ 49\ 846$ ;  $Z - +740\ m$ ;

Prurja mesatare vjetore e burimeve:  $Q_{1mes} = 0.535\ m^3/sek$ ;  $Q_{2mes} = 0.094\ m^3/sek$ ;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q_{llog} = 0.75\ m^3/sek$ ;

Prurja ekologjike:  $Q_{ekol} = 0.164\ m^3/sek$ ;

Prurja që shkarkohet:  $Q = 0.75\ m^3/sek$ .

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**  
**Raimonda GURI**



**KRYETAR**  
**Cesk MILLJA**

